



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT**

**PROCESVERBAL
PËR
“KONSULTIMIN PUBLIK PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE, BASHKIA KAMËZ,
PRANË AMBIENTEVE TË PALLATIT TË KULTURËS”**

I mbajtur sot më 26.03.2026, ora 14:00, pranë ambienteve të pallatit të kulturës, takimi filloi me prezantimin e rregullores në disa pika përmbledhëse ku Rregullorja e Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (RRMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Të pranishëm në takim ishin:

- Inxhinier e Mjedisit e Ndërmarrjes së Pastrimit Kamëz, znj. Manushaqe Dragjoshi
- Përgjegjëse e Sektorit të Pastrimit të Ndërmarrjes së Pastrimit Kamëz, znj. Endrijeta Gjini.
- Specialist Terreni të Ndërmarrjes së Pastrimit Kamëz, znj. Aurora Sopaj.
- Përgjegjëse e Sektorit Juridik të Ndërmarrjes së Pastrimit Kamëz, znj. Arnela Shahu
- Banorë të Kamzës.

Takimin e hapi Inxhinierja e Mjedisit, znj. Manushaqe Dragjoshi dhe Përgjegjësja e Pastrimit të Kamzës, znj. Endrijeta Gjini, pasi falenderuan të pranishmit për pjesëmarrjen, theksuan rëndësinë e procesit të konsultimit publik.

Në vijim nga grupi i punës u fol për rëndësinë që ka kjo rregullore e cila mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. RRMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Të pranishmit në këtë konsultim shtruan diskutime në lidhje me:

- i) Shërbimi i pastrimit të rrugëve;
- ii) Shërbimi i grumbullimit, transportit i mbetjeve;
- iii) Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Sharrës;
- iv) Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Në mbyllje të takimit u reflektuar mbi ndihmën që jep Rregullorja Rregullorja e Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (RRMNU) në komunitetin e Kamzës dhe dosmosdoshmëria e saj.